

## KONTRATE

për krijimin e  
**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**(“INSTITUTI I MODELIMEVE NE BIZNES ” - IMB Sh.p.k.)**

e lidhur sot më 15/09/1997 ndërmjet

- 1) Maksi Raço, datelindja 1952, banues në Tiranë: Rruga Ali Demi, Pallati 141, Shkalla 1, Ap 5
- 2) Kosta Ekonomi, datelindja 1948, banues ne Tirane: Rr. F.Xhajko, Pallati 65/4, Shk 1, Ap 12
- 3) Alban Hoxha, datelindja 1973, banues ne Tirane: Qyteti Studenti, Godina 13

Të tre ortakët bien dakord për sa vijon:

### Neni 1

Të krijojnë një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara për zhvillimin e aktiviteteve industriale, tregtare dhe ekonomike të quajtur: **“INSTITUTI I MODELIMEVE NE BIZNES ” - IMB Sh.p.k.**

Kjo shoqëri do të ketë selinë në Tiranë dhe do të ushtrojë aktivitetin e vet për një periudhë prej 12 vjetësh, me të drejtën për ta shtyrë ose rinouar për periudha të mëtejshme me martëveshjen unanime të ortakëve, konform me Legjislacionin Shqiptar.

### Neni 2

Shoqëria **“INSTITUTI I MODELIMEVE NE BIZNES ” - IMB Sh.p.k.** është person juridik shqiptar dhe aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, të Statutit dhe të Legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe veçanërisht sipas dispozitave të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" dhe Nenit 64 të Ligjit 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar".

Statuti i shoqërisë do t'i bashkëngjitet kësaj kontrate.



Objekti i Shoqërisë **“INSTITUTI I MODELIMEVE NE BIZNES ” - IMB Sh.p.k.** do të jetë si vijon:

- veprimtari në fushën e informatikës;
- prodhim programesh për kompjutëra dhe shitjen e tyre me shumicë e pakicë;
- eksport-import dhe shitje me shumicë e pakicë të pajisjeve informatike e elektronike, e të tjera;
- kurse kualifikimi në fusha të ndryshme të shkencës, ekonomisë, aplikimeve të ndryshme, dhe në veçanti në fushën e informatikës, ekonomisë, financës e të biznesit;
- instalime programesh për kompjutëra, pajisjesh elektrike e elektronike, aparaturash dhe pajisje të ndryshme;
- investime në fushën e sistemeve të informacionit ekonomik, gjografik, në fushën e industrisë, transportit, ndërtimit dhe turizmit;
- studime fizibiliteti ne fushen e infrastrukturies se transportit, puneve publike e turizmit.
- aktivitete të transportit tokësor, detar dhe ajror;

- aktivitete të kontrollit dhe revizionit të veprimtarisë së personave juridikë e fizikë private apo shtetërorë, si dhe konsulencë ekonomike;
- konsulencë dhe asistencë ligjore;
- përkthime dokumentesh;
- shoqëria, përveç këtyre, mund të kryejë çdo veprim që hyn në sferën e aktivitetit të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm administrativ, që i përbahen dhe rrijedhin nga objekti i veprimtarisë së saj, duke iu përbajtur gjithmonë normave ligjore në fuqi.

#### **Neni 4**

Me miratimin e kësaj shoqërie nga ana e organeve kompetente, vlerat natyrale të kapitaleve sipas vlefshës së tyre kalojnë në pronësi të vetë shoqërisë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj me cikël të mbyllur.

#### **Neni 5**

#### **KAPITALI I SHOQERISE DHE KUOTAT**

Kapitali themeltar i Shoqërisë **“INSTITUTI I MODELIMEVE NE BIZNES ” - IMB Sh.p.k.** përbëhet prej **100'000 Lek** dhe ndahet në 100 njësi të barabarta nga 1'000 Lek secila, me numër serie nga 1 deri 100, të cilat ndahen ndërmjet ortakëve si vijon:

- 40 njësi Maksi Raço, baraz me 4/10 e tërë kapitalit, me numër serie nga 1 deri 40,
- 30 njësi Kosta Ekonomi, baraz me 3/10 e tërë kapitalit, me numër serie nga 41 deri 70.
- 30 njësi Alban Hoxha, baraz me 3/10 e tërë kapitalit, me numër serie nga 71 deri 100.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë të nënshkruara dhe të shlyeshme plotësisht nga ortakët. Ortakët gjëzojnë të drejtën të tërheqin fondet e nevojshme të kapitalit themeltar nga Banka në të cilën kanë çelur llogarinë.

#### **Neni 6**

Kuotat e ortakëve në shoqëri, në para, derdhen në favor të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të ndryshojë në varësi të nevojave të shoqërisë me marrëveshjen ndërmjet ortakëve.

Kapitali i nënshkruar, respektivisht do të regjistrohet në llogaritë e shoqërisë dhe do të jepet një certifikatë për çdo kuotë të derdhur.

#### **Neni 7**

E ardhura e realizuar nga shoqëria ndahet dhe administrohet siç është parashikuar në Statutin respektiv të kësaj shoqërie.

#### **Neni 8**

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve;
- Administratorët;

- Ekspertët kontabël.

Procedurat për emërimin dhe për funksionet relative, do të përcaktohen nga Statuti konform me Legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 9**

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit, dhe të përvojave të këmbimit të realizuara brenda aktivitetit të shoqërisë, duke evitar edhe përhapjen e pjesshme.

Ortakët janë përgjegjës për pasojat e dëmshme të shkeljes së një detyrimi të tillë, kur kjo shkelje është rezultat i një veprimi të toleruar ose e neglizhencës.

#### **Neni 10 MOSMARREVESHJET**

Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen paraprakisht nëpërmjet bisedimesh, zgjidhen nga Gjykata e rrëthit të Tiranës.

#### **Neni 11 SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI**

Në rast shkrirje, Asambleja përcakton mënyrat e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidues sipas normave Ligjore.

#### **Neni 12**

Dispozita të tjera të detajuara përcaktohen nga Statuti.

#### **Neni 13**

Kontrata aktuale përpilohet në tre kopje origjinale, të barazvlefshme për çdo efekt, të nënshkruara vullnetarisht nga ortakët.

### **ORTAKËT**

**MAKSI RAÇO**



**KOSTA EKONOMI**



**ALBAN HOXHA**

